



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, Saranda Bogaj - Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kosmonte Foods” Shpk nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, vlerësim doganor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.808/20 të datës 13.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Kosmonte Foods” Shpk nga Prishtina ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.808/20 të datës 13.07.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Kosmonte Foods” Shpk nga Prishtina dhe ka lënë në fuqi aktvendimin me nr.01.3.2.2/608, 609, 610, 611, 612, 613, 614, 615 dt.19.02.2020 te Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi, ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat E.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovet si e bazuar ankesa e paditësit, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose aktgjykim i atakuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallë të parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63.2 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.01.3.2.2/671 dt.06.02.2020 ka refuzuar kërkesat e subjektit në procedurë “Kosmonte Foods” Shpk nga Prishtina, për rishqyrtimin e vendimeve nr.R-14788/17.12.2019, R-14789/17.12.2019, R-14786/17.12.2019, R-14796/17.12.2019, R-14784/17.12.2019, R-14790/17.12.2019, R-14795/17.12.2019, R-14791/17.12.2019, e Zyrës së Brendshme Doganore në Merdare, si të pabazuara, ndërsa ka lënë në fuqi këto vendime.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ-Divizioni Fiskal për këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor me datë 13.07.2021 në prani të përfaqësuesit të paditësit avokat E.B. ndërsa e Paditura edhe pse e ka pranuar thirrjen me datën 12.07.2021 përmes parashtrës njofton gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë, ashtu që propozon që gjykata të veproj konform nenit 38 pika 5 e LKA.

Gjykata pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa e lë në fuqi aktvendimin e organit të paditur nr.01.3.2.2/608, 609, 610, 611, 612, 613, 614, 615 dt.19.02.2020. Sipas theksimeve si në arsyetim, e ndër të tjera se: Nga provat e administruara në konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, kjo sepse as në konfliktin administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlera e vërtetë e transaksionit të paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit –eksportuesit të mallit lëndor. Pala e paditurës nuk ka arrit të dëshmoj se është paguar malli lëndor prandaj edhe gjykata ka pranuar konstatimet e cekura në arsyetim të vendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme pasi që fakt vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor e që në këtë rast është vlera e transaksionit bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar, paditësi nuk ka qenë në gjendje që ta dëshmoj as në procedurën administrative dhe as në konfliktin administrativ. E paditura në rastin konkret për vlerësimin e mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit respektivisht katalogut online schwacke.net. Gjykata konsideron se paditësi nuk ka arrit të dëshmoj vlerën e transaksionit të paguar për mallin lëndor, e njëjta ka paraqit dokumentacion përcjellës të mallit lëndor të zhdoganuar për DUD-at kontestues, faturat përcjellëse e të mallit, pagesën bankare, faturat e shpenzimeve, deklaratat e tranzitit por në vështrim të nenit 81.F par.1 të ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr.03/L-222, për arsye se gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se është bere pagesa e mallit lëndor. Nga urdhër pagesa ndërkombëtare e datës 12.03.2019 në TEB, shihet se kjo pagesë ndërkombëtare ende është në status ”në pritje për tu ekzekutuar” që do të thotë se nuk është transaksion përfundimtar dhe nuk është ekzekutuar në destinacionin e përfituesit, kështu që nuk ka pranuar pretendimet se dokumentacioni përcjellës i mallit është në përputhje me nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë 03/L-109. Konstaton se në këtë konflikt administrativ nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit andaj theksimet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoi si pa ndikim në vërtetimin e gjendjes faktike tjetër nga ajo e vërtetuar nga organet administrative, sepse nuk janë paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin ehste

kryer transaksioni i mallit lëndor, prandaj gjykata konstaton se vendimi 01.23.2.2/671 dt.06.02.2020 i Doganës së Kosovës është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozita ligjore.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i kësaj gjykate, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, e as me aplikim të gabuar të dispozitave materiale, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjënë se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-202 të LKA, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të atakuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka dëshmuar me dokumentacion adekuat se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor, pra paditësi nuk ka arrit të argumentoj me prova gjegjësisht transaksione bankare se kjo vlerë e mallit të deklaruar është paguar sipas atij transaksioni bankar. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se nga shkresat në lende përkatësisht nga pagesa ndërkombëtare e datës 12.04.2019 në TEB, pagesa e transaksionit ka mbetur në statusin “*Ne pritjeje për tu ekzekutuar*”, andaj bazuar në këtë fakt edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se dokumentacioni i mallit i prezantuar nga paditësi nuk është provë e mjaftueshme për tu dëshmuar se është paguar në të vërtetë vlera e transaksionit apo se paditësi ka paraqitur dokumentacionin e duhur në bazë të cilit më pas Dogana e Kosovës do të duhej ta vlerësonte mallin sipas metodës së parë të vlerësimit nga neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë 03/L-109.

Kolegji kësaj gjykate ashtu si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se Dogana e Kosovës, bazuar në faktet e cekura si më lartë me të drejtë ka aplikuar metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit, neni 35 i KDA-së, ku në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës, është bërë përcaktimi i çmimit real të zhdoganimit, e jo ai i deklaruar nga subjekti, sipas dokumenteve përcjellëse të mallit.

Pretendimet ankimore të ankuesit nga shkaqet e cekura si më lart, kolegji i refuzon si të pa bazuara dhe jo me ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, nga ajo që është vendosur në gjykatën e shkallës së parë, sepse nuk dëshmohet se gjykata e shkallës së parë gjatë vendosjes ka bërë cenim të dispozitave procedurale, e po ashtu gjendja faktike e çështjes gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së Aktvendimit të organit të paditur është vërtetuar në mënyrë të plotë. Kolegji po ashtu vlerëson se dëshmitë në të cilat thirret në ankesë paditësi, vërtetohet se nga gjykata e shkallës së parë janë shqyrtuar në tërësi, por nuk është arritë të dëshmohet se janë prova të qëndrueshme dhe bindëse materiale, për tu dëshmuar është kryer transaksioni dhe është bërë pagesa e mallit lëndor ashtu siç është deklaruar.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, edhe kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, prandaj, pretendimi ankimor se gjykata nuk beri vërtetimin e drejtë të provave të ofruara nga paditësi dhe se kompania Kosmonte

Foods u dëmtua në mënyrë financiare duke i dhënë të drejtë Doganës së Kosovës për rritjen e masës doganore pa bazë ligjore, këtë pretendim ankimor ky kolegji nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se është i pa bazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore e as në prova për tu aprovuar ankesa, për faktin se gjykata e shkallës së parë nga administrimi i të gjitha provave në këtë procedurë të konfliktit administrativ ka ardhur në përfundim se paditësi nuk ka paraqitur fakt se është paguar vlera e mallit sepse në fakt transferi ndërkombëtar ka mbetur në pritje ashtu që nuk mundet të veprohet sipas kërkesës së paditësit që malli të vlerësohet sipas dokumentacionit të prezantuar.

Ky kolegji vlerëson se po ashtu nuk qëndron as pretendimi i palës paditëse se gjykata e shkallës së parë ka nxjerr përfundime juridike të gabuara në aktgjykimin e saj e kjo sepse sipas këtij kolegji gjykata e shkallës së parë bazuar në shkresat dhe provat në lende ka marrë vendimin e saj të bazuar dhe mbështetur në prova dhe se paditësi nuk ka mundur të argumentoj këto pretendime me prova konkrete mbi bazën e të cilave me pastaj gjykata do të merrte një vendim tjetër dhe se në rastin konkret është vërtetuar bindshëm dhe në mënyrë të pa kontestuar se nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme që dëshmojnë se paditësi ka paguar në të vërtetë vlerën e mallit lëndor të deklaruar.

Andaj, mbi bazën e këtyre arsyeve, ky kolegji vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë, i kuptueshëm si dhe i drejtë dhe i ligjshëm, përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë dhe si i tillë u vërtetua ndërsa ankesën e paditësit u refuzon si të pa bazuar.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1012/22, dt.05.12.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami